ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-23-8090-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Blerja e shërbimeve për hulumtime, shqyrtime, analiza dhe projektime**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Horn and Co. Analytics SH.P.K.**
NUI	**811881962**
Adresa	**Petra Bojovica pn Lapllaselle**
Vendi	**Gracanice**
Kodi postar	**10500**
Numri Telefonit	**048885666**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Argjend Halili**
Adresa elektronike	**argjend.halili@horn-co.de**
Data e parashtrimit të ankesës	**20.06.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Sherbimet e gjeol&hidrol, gjeomakanikes, analizat e qymyrit, zgures, hirit[]Analiza laboratorike ditore te vajrave dhe emulzionit[]Analizat laboratorike te kemikaleve, mjedisi (uji, ajri, toka), virbimet, zhurma[]Shqyrtimet, matjet elektrike, mbrojtja në punë

Korporata Energjetike e Kosovës sh.a., me datën 03/08/2023, ka bërë shpalljen e Njoftimit te Kontratës kurse afati për dorëzimin e tenderit ka qenë me datën 12/09/2023.

Kriteri: çmimi me i ultë.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Grupi i Operatorëve Ekonomik 'Horn and Co. Analytics SH.P.K.; GEOKOS A & A O.P.; Horn & Co. Analytics GmbH; A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000', me daten 09 janar 2024, ka parashtruar Kerkesen e Pare per Rishqyrtim dhe mepastaj edhe Kerkesen e Dyte per Rishqyrtim, duke ofruar argumente ligjore per shkelje te neneve 59 dhe 28 te Ligjit te Prokurimit Publik, me nr. 04 / L – 042, per shkak se

Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar asnje arsyetim ligjor ne te gjitha argumentet ligjore te prezentuara qarte ne Kerkesen per Ri-shqyrtim.

Me daten, 10 qershor 2024, kemi parashtruar edhe Kerkesen e Trete per Rishqyrtim ne Autoritetin Kontraktues per shkak se dy herave te kaluara kur eshte bere procesi i vleresimit dhe ri-vleresimit te ofertave eshte bere ne kundershtim me nenin 59 te LPP-se dhe nuk jane marre parasysh argumentet tona ligjore duke mos ofruar pergjigje konkrete dhe ligjore dhe teknike ne te gjitha argumentet tona ligjore kunder O.E te shpallur fitues 'Inkos'.

Ne te gjitha keto Kerkesa per Rishqyrtim, kemi potencuar se vendimi i Autoritetit Kontraktues per eliminim nga tenderi per aktivitetin e prokurimit per Lot 1 - Shërbimet gjeologjike & hidrologjike, gjeomekanikes, analizat e qymyrit, zgures dhe hirit vetem per shkak nje gabimi administrativ / teknik eshte subjektiv dhe jo ligjor ngase ka mundur te aplikoje dhe zbatoje nenin 59.4 te LPP-se per shkak se oferta jone eshte permbajtesore dhe performuese ne pajtim te plote me te gjitha kerkesat teknike, financiare dhe ligjore por me nje devijim te vogel, ashtu sic eshte kerkuar ne Dosje te Tenderit.

Gjitheashtu, kemi kundershtuar pohimet e pabazuara te Autoritetit Kontraktues qe perkunder shume mangesive te O.E te shpallur fitues 'Inkos' ne tri procese te Ri-vleresimit te ofertave, te njejtin O.E e shpall perseri fitues te tenderit.

Si rrjedhoje, ne Kerkesen per Rishqyrtim, kemi potencuar se Autoriteti Kontraktues gjate procesit te dhe Ri-vleresimit te Ofertave eshte duke favorizuar skajmerisht O.E 'Inkos' per shkak se ky O.E nuk i permbush kerkesat teknike, financiare dhe ligjore, te kerkuara ne nenin 3.1 dhe 3.2 te Dosjes se Tenderit.

Duke u nisur nga kjo, Autoriteti Kontraktues, ka bere shkelje te rende te nenit 59, te Ligjit te Prokurimit Publik, me nr. 04 / L – 042 ngase me veprime te tilla te pabazuara ligjore ka bere vleresim subjektiv, jo ligjore dhe jo profesional.

Ne argumentet ligjore qe do te prezentohen ne Ankesen drejtuar OSHP-se do te konstatohet se Oferta e Grupit te Operatoreve Ekonomik 'Horn and Co. Analytics SH.P.K.; GEOKOS A & A O.P.; Horn & Co. Analytics GmbH; A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000' eshte Oferte e pergjegjeshme dhe Oferte performuese ne pajtim te plote me te gjitha kerkesat dhe kushtet teknike te kerkuara nga Autoriteti Kontraktues, ashtu sic kerkohet me nenin 3 dhe nenit 3.1 te Dosjes se Tenderit .

Me daten 12 qershor 2024, Autoriteti Kontraktues, refuzon Kerkesen e Trete per Rishqyrtim dhe pergjigjet duke mos ofruar argumente konkrete ligjore me arsyetim ligjor ne te gjitha argumentet ligjore dhe argumentet teknike te Grupit te Operatoreve Ekonomik 'Horn and Co. Analytics SH.P.K.; GEOKOS A & A O.P.; Horn & Co. Analytics GmbH; A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000', ne menyre konkrete dhe ligjore por vetem me nje vleresim te pabaze kinse konstatimet nuk qendrojne dhe ben 'kopjim' te arsyetimeve te saja qe vec jane dhene per eliminim ne Letren per Tenderuesin e Eliminuar.

Refuzimi i Autoritetit Kontraktues pa ofruar argumente ligjore ne te gjitha pretendimet ankimore me arsyetim ligjor dhe argumente teknike eshte ne kundershtim me nenin 108 / A te Ligjit te Prokurimit Publik, me nr. 04 / L - 042 dhe me nenin 8 te Rregullave per parashtrim te ankesave dhe flet qarte per subjektivizimin e larte te Autoritetit Kontraktues ne vleresimin e Kerkeses per Rishqyrtim.

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Grupi i Operatoreve Ekonomik 'Horn and Co. Analytics SH.P.K.; GEOKOS A & A O.P.; Horn & Co. Analytics GmbH; A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000', pas analizimit dhe studimit te dokumenteve relevante te Autoritetit Kontraktues dhe pas Vendimit te saj kunder Kerkeses per Ri-shqyrtim ne proceduren e prokurimit per: Lot 1 - Shërbimet gjeologjike & hidrologjike, gjeomekanikes, analizat e qymyrit, zgures dhe hirit konsideron se Autoriteti Kontraktues, ka bere shkelje te dispozitave ligjore te Ligjit te Prokurimit Publik te Kosoves me nr. 04 / L – 042.

Dispozitat e shkelura nga ***Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosoves,*** jane mese vijon:

Eshte shkelur neni 59., i Ligjit te Prokurimit Publik

Eshte shkelur neni 27 dhe 28 , i Ligjit te Prokurimit Publik

Eshte shkelur neni 59.4, i Ligjit te Prokurimit Publik

Eshte shkelur neni 69, i Ligjit te Prokurimit Publik

Eshte shkelur neni 1, 2, 6, dhe 7, i Ligjit te Prokurimit Publik

Eshte shkelur neni 3 dhe neni 3.1, i Dosjes se Tenderit

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Grupi i Operatoreve Ekonomik 'Horn and Co. Analytics SH.P.K.; GEOKOS A & A O.P.; Horn & Co. Analytics GmbH; A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000', pas analizimit te teresishem te dokumenteve relevante te Tenderit per: Shërbimet gjeologjike & hidrologjike, gjeomekanikes, analizat e qymyrit, zgures dhe hirit konstaton dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosoves, ka bere shkelje ligjore ne mos vleresimin e drejte, ligjor dhe objektiv te Ofertes sone qe eshte Oferte performuese dhe Oferte e pergjegjshme ne pajtim te plote me kerkesat, kushtet dhe kriteret e percaktuara ne Dosje te Tenderit.

Pikat e Ankeses per shkeljet e pretenduara te Autoritetit Kontraktues *jane te prezentuara si vijon*:

Autoriteti Kontraktues, me datën 04/01/ 2024, përgatit dhe dorëzon Publikimin dhe Vendimin për dhënie të kontratës publike në Portalin e E-prokurimit.

Nëpërmjet këtij publikimi, Autoriteti Kontraktues, i ka prezantuar arsyet e dhënies të kontratës publike O.E të shpallur fitues Lot 1 - Shërbimet gjeologjike & hidrologjike, gjeomekanikes, analizat e qymyrit, zgures dhe hirit;

Grupi i Operatorëve Ekonomik 'Horn and Co. Analytics SH.P.K.; GEOKOS A & A O.P.; Horn & Co. Analytics GmbH; A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000', menjëherë pas publikimit të Njoftimit për Dhënie të Kontratës, me datën 05/01/2024, ka parashtruar kërkesën për qasje publike te dokumenteve për O.E të shpallur fitues Grup i Operatorëve Ekonomik 'Instituti INKOS sh.a.; IMK Ballkan Projekt sh.p.k.; Korporata Sara&Meti sh.p.k.; N.SH. Agrovet; Qendra e Monitorimit te Mjedisit RZ Tehnicka Kontrola AD'.

Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a., ofron qasje në të gjitha dokumentet ofertuese të O.E të shpallur fitues dhe në bazë të dokumentacionit të ofruar kemi konstatuar se këtij Konsorciumi i mungojnë dokumentet ligjore dhe si e tillë oferta e këtij Konsorciumi është dashur të shpallet e pavlefshme

Lidhur me kete, me daten 09 janar 2024, Konsorciumi, parashtron Kerkesen per Rishqyrtim prane Autoritetit Kontraktues, duke ofruar fakte permbajtesore qe O.E i shpalluar fitues nuk i permbush kushtet dhe kriteret teknike, ekonomike, ligjore dhe financiare dhe ka kerkuar aprovimin e teresishem te Kerkeses per Rishqyrtim;

Autoriteti Kontraktues, me daten, 17 janar 2024, e ben aprovimin e pjeserishem te Kerkeses per Rishqyrtim dhe me daten 01 shkurt 2024, e formon Komisionin e Ri te Ri-vleresimit te ofertave per te shqyrtuar perseri tere procesin e aktivitetit te prokurimit dhe per te marre vendim perfundimtar;

Autoriteti Kontraktues, nepermjet Komisionit per Ri-vleresim te Ofertave, me daten 15 shkurt 2024, i drejtohet me shkrim O.E te shpallur fitues 'Instituti INKOS sh.a.; IMK Ballkan Projekt sh.p.k.; Korporata Sara&Meti sh.p.k.; N.SH. Agrovet; Qendra e Monitorimit te Mjedisit RZ Tehnicka Kontrola AD' per te sqaruar nje pjese te ofertes sa i perket ceshtjes se perfshirjes ne Oferte te Softwerit per llogaritjen e Qendrueshmerise se shpatave per llogaritjen ne forme rrethore dhe poligonale te rrafshit rreshiqtes.

O.E i shpallur fitues 'Instituti INKOS sh.a.; IMK Ballkan Projekt sh.p.k.; Korporata Sara&Meti sh.p.k.; N.SH. Agrovet; Qendra e Monitorimit te Mjedisit RZ Tehnicka Kontrola AD', me daten 16 shkurt 2024,

ofron pergjigjen ne kerkesen per sqarime per ceshtjen kontestuese te 'softwerit' per llogaritje te Qendrueshmerise se shpatave por pa specifikuar ne menyre konkrete dhe teknike se Softweri AGIK sic pretendon ky O.E i shpallur fitues i permbush te gjitha parametrat teknike per llogartije te Qendrushmerise se shpatave per llogaritje ne forme rrethore dhe poligonale te rrafshit rreshqites (*shih te bashkengjitur Kerkesen per sqarime dhe ofrimi i sqarimeve nga 'Inkos shpk'*).

Gjitheashtu, ne pergjigjen e ketij O.E te shpallur fitues nuk ka deshmi/informacione konkrete, ligjore dhe zyrtare per aplikueshmerine dhe posedimin e licences se softwerit AGIK per aplikim praktik dhe kompleks ne punen ditore te aplikimit te saj.

Si rrjedhoje, INKOS, ka paraqitur 4 faqe pjese te Raportit te mehereshem ku thuhet se eshte kalkuluar pjerretesia e shpateve me softwerin AGIK (ku prape e kane shkruar vete) ngasec cdokush mund te marre foto te kalkulimeve te shpateve dhe ti i vendos ne disa faqe te raporteve. Kjo ne asnje rrethane nuk deshmon se posedojne Softwerin AGIK.

O.E INKOS ne nje rresht te faqes 53 te Dosjes se Tenderit thekson se posedon Softwerin per llogaritjen e qendrueshmerise se shpateve me Softwerin AGIK por ky rresht ne asnje rrethane ligjore nuk konsiderohet Deshmi se ata posedojne Softwerin AGIK dhe cdo person se mund te cek se posedon Softwer te tille por duhet te ofroje Deshmi Ligjore.

Ne kete drejtim, po e ri-kujtojme, Autoritetin Kontraktues, se ne Dosje te Tenderit ne menyre specifike ka kerkuar: **qe O.E duhet te ofroje DESHMI** permese listes se dhene, fotove ose dokumentacionit tjeter se posedon mjetet, stabilitetet, pajisjet teknik si: Software per llogaritjen e qendrueshmerise se shpateve per llogaritjen ne forme rrethore dhe poligonale te rrafshit rreshqites.

Ne Oferten e O.E 'INKOS' nuk ka asnje Deshmi ligjore me fature te blerjes, me nr. te Licences per posedimin e Softwerit per llogaritjen e qendrueshmerise se shpateve dhe ne kete drejtim Deshmi nuk mund te konsiderohen disa foto te shpateve dhe nje rresht qe kane vendosur ne Oferten e tyre.

Ekspertet teknike te Konsorciumit 'Horn and Co. Analytics SH.P.K.; GEOKOS A & A O.P.; Horn & Co. Analytics GmbH; A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000' pas analizimit te ofrimit te pergjigjes ne kerkesen per sqarime te KEK-ut drejtuar O.E te shpallur fitues konstatojme se **mungon Deshmite per blerjen e Softwerit AGIK, ashtu sic ka kerkuar Autoriteti Kontraktues ne Dosje te Tenderit dhe i se i njejti O.E duhet te shpallur i papergjeshem dhe ne teresi te i refuzohet Oferta.**

Grupi i Operatorëve Ekonomik 'Horn and Co. Analytics SH.P.K.; GEOKOS A & A O.P.; Horn & Co. Analytics GmbH; A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000'**, me date 10 qershor 2024, pergadit dhe dorezon**

Kerkesen e Trete per Rishqyrtim ne Autoritetin Kontraktues duke ofruar argumentet ligjore per eliminim te ofertes se O.E te shpallur fitues qe nuk i permbush kushtet dhe specifikimet teknike sipas nenit 28 te LPP-se si dhe te gjitha kushtet tjera ekonomike, financiare, teknike dhe ligjore, te kerkuara sipas nenit 3.1 dhe 3.2 te Dosjes se Tenderit dhe arsyet e kundershtimit per shpalljen e ofertes se O.E Inkos si oferte te sukseshme **por Autoriteti Kontraktues, me daten 12 qershor 2024**, pa ofruar argumente thelbesore dhe teknike dhe ligjore ne te gjitha argumentet tona ligjore, e refuzon Kerkesen per Rishqyrtim;

Grupi i Operatorëve Ekonomik 'Horn and Co. Analytics SH.P.K.; GEOKOS A & A O.P.; Horn & Co. Analytics GmbH; A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000' konsideron si jo ligjore vendimin e Autoritetit Kontraktues te refuzoje Ofertën tonë per shkak që Nen-kontraktuesi i deklaruar (Caja Company shpk) nuk ka ofruar Deklaratën për Nen-betim.

Ky arsyetim i Autoritetit Kontraktues nuk duhet te shërbejë si baze ligjore për eliminim nga procesi i ofertimit për arsye se me nenin 17.19 te Rregullores për Prokurim Publik me nr.01 / 2022 **nuk ka asnjë pengese ligjore** qe Autoriteti Kontraktues te aplikoje dhe zbatoje nenin 59.4 te Ligjit te Prokurimit Publik qe mos dorëzimi i Deklaratës nen-betim te nënkontraktuesit te deklaruar 'Caja Company' shpk te mos konsiderohet gabim i vogël teknik ne mënyrë që Oferta e jone te përzgjidhet fitues i tenderit qe ka ofruar çmim te volitshëm dhe ne pajtim me buxhetin e parapare për këtë aktivitet te prokurimit.

Ju njoftojmë se 'përqindja' e punës se nen-kontraktuesit 'Caja Company' është vetëm **0.6 %** e tere vlerës se kontratës publike dhe ka vetëm përqindje te vogël te implementimit dhe si e tille është e padrejte dhe jo ligjore edhe sipas Rregullores për Prokurim Publik dhe sipas Ligjit te Prokurimit Publik te Kosovës qe ky gabim i vogël teknik i Deklaratës nen betim te nënkontraktuesit 'Caja Company' shpk te mos konsiderohet gabim i vogël teknik qe nuk përbën asnjë ndryshim material ne Ofertën e Konsorciumit dhe nuk ka asnjë ndikim përmbajtjesore te implementimit te kontratës nga ana e Konsorciumit tone.

Është me rëndësi te potencohet se kemi dorëzuar Kontratën që do të shfrytëzojmë Nen-kontraktues përveç qe nuk kemi potencuar përqindjen e nen-kontraktimit te punëve qe do te beje Nen-kontraktuesi ne kuadër te Projektit dhe nuk kemi dorëzuar dokumentet e përshtatshmërisë se nen-kontraktuesit 'Caja Company' shpk por mos dorëzimi i këtyre dokumenteve qe tash Autoriteti Kontraktues i konsideron si te domosdoshme **është pasoje e ç`orientimit dhe dezorientimit ngase Autoriteti Kontraktues ne Dosje te Tenderit nuk ka kerkuar ne mënyrë specifike dhe ne mënyrë ligjore shprehimisht ne Fletën e te Dhënave te Dosjes se Tenderit se sa perqind te vlerës se kontratës publike mundet te ja nënkontraktojë Ofertuesi ndonjë nënkontraktuesi potencial**.

Autoriteti Kontraktues ne Fletën e te Dhënave te Dosjes se Tenderit vetëm ka kerkuar nga Operatoret Ekonomik qe nëse dëshirojnë munden te nominojne nen-kontraktuesit dhe te dorëzojnë dokumentet e përshtatshmërisë por pa e specifikuar 'përqindjen' deri ne sa perqind mund te ja nen-kontraktoje punët për ketë aktivitet te prokurimit.

Ne baze te Rregullores për Prokurim Publik nr. 1 / 2022 ne nenin 17.19 ceket qe ne deri 40 % mund te nen-kontraktohet një kontrate publike nga Operatoret Ekonomik por është dashur

Autoriteti Kontraktues te jap një 'përqindje' ne nenin 12.1 te Fletës se te Dhënave te Tenderit ne mënyrë qe Operatoret Ekonomik te dine 'përqindjen e nen-kontraktimit' dhe ne baze te saj te përgatisin Dokumentet e Përshtatshmërisë për Nen-kontraktuesit dhe te evitojnë gabimet teknike.

Duke u nisur nga kjo, si Ofertues, kemi qene te c`orientuar nga formulimi i nenit 12.1 te Dosjes se Tenderit për Nënkontraktuesit dhe pa dashje ne Oferte kemi harruar qe nënkontraktuesit te deklaruar 'Caja Company' shpk te dorëzojmë Deklaratën nen betim dhe për ketë gabim te vogël teknik jemi te penalizuar me eliminim nga konkurrenca dhe refuzim te ofertës sonë.

Është e padrejte qe **Autoriteti Kontraktues te eliminoje padrejtësisht Oferten tone për çështjen e nen-kontraktuesit dhe te penalizoje për gabimin e vogël teknik dhe qe ka ç`orientuar stafin e Konsorciumit** gjate përgatitjes se ofertës për Korporatën Energjetike te Kosovës.

Duke marre parasysh qe Oferta jone është me e lire dhe oferte përmbajtjesore qe përmbush te gjitha specifikimet teknike te detyrueshme dhe te gjitha kushtet tjera teknike dhe financiare atëherë Autoriteti Kontraktues për këtë lëshim te vogël teknik për çështjen e nen-kontraktuesit 'Caja Company' shpk dhe mos dorëzimit te Deklaratës për nen betim për ketë Nënkontraktues, **te aplikoje ne praktike nenin 59.4 te Ligjit te Prokurimit Publik dhe te konsideroje kete çështje si gabim i vogël teknik** qe nuk ndryshon aspektin material te Ofertës se Konsorciumit tone;

Konsorciumi, e konsideron si favorizim te skajshem O.E te shpallur fitues ku perkunder mungeses esenciale te plotesimit te kushteve dhe kritereve teknike dhe financiare te shpallet fitues ky O.E kurse per nje gabim te vogel teknik dhe qe kemi ofruar cmimin me te lire se ky O.E dhe O.E tjere pjesemarres ekonomik te penalizohemi duke refuzuar Oferten e Konsorciumit 'Horn and Co. Analytics SH.P.K.; GEOKOS A & A O.P.; Horn & Co. Analytics GmbH; A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000'.

Prandaj, si Konsorcium, konsiderojme se Autoriteti Kontraktues – KEK sh.a, ben shkelje te nenit 6 dhe nenit 7 te Ligjit te Prokurimit Publik duke favorizuar skajshem O.E te shpallur fitues dhe duke diskriminuar rende Konsorciumit tone dhe duke demtuar ne menyre financiare dhe ekonomike buxhetin e KEK-ut;

Konsorciumi, me daten 13 mars 2024, i eshte drejtuar Autoritetit Kontraktues, ne ofrimin e qasjes publike te dokumenteve te O.E te shpallur fitues dhe Autoriteti Kontraktues, ne te njejten dite ka ofruar qasje dhe ne baze te shiqimit te dokumentacionit kemi verejtur edhe vertetimin e leshuar nga ATK-ja per O.E 'Inkos' shpk te dates 23 nentor 2023 qe vlen per afatin 90 ditor ku potencohet se ky O.E ka marreveshje me keste me ATK-ne ne pagese te tatimit te mbetur (borxhi) qe aktualisht ky vertetim tatimor eshte i pavlefshem dhe jo ligjor.

Ne kete drejtim, Konsorciumi, do te i drejtohet ATK-se qe ne menyre ligjore do te kerkoje informata nese O.E 'Inkos' shpk ka paguar borxhet e kaluara dhe aktuale ne menyre qe sipas nenit 6.4 (kerkesat e pershtateshmerise), pika 2 te Dosjes se Tenderit te permbushet nga O.E i shpallur fitues.

Gjate procesit te ri-vleresimit te ofertave per here te Trete **shihet qe O.E i shpallur fitues Inkos ka prezentuar nje Deklarate Tatimore te muajit 15 Prill 2024 qe nuk ka borxhe tatimore ne ATK** edhe pse KEK duhet te verifikoje te dhenat drejteperdrejte ne ATK nese ne te vertete kjo Deklarate Tatimore e muajit Prill 2024 eshte valide ose jo dhe ne baze te saj te marr nje vendim te drejte ligjor.

Ne rast te mos pageses direkte te borxheve te mbetura tatimore ose ne mungese te marreveshjes me ATK-ne, ky O.E dhe anetaret e tjere te Konsorciumit duhet te shpallen te papergjegjeshem dhe te ju refuzohet Oferta;

Përfaqësuesit e Grup i Operatorëve Ekonomik Horn and Co. Analytics SH.P.K.; GEOKOS A & A O.P.; Horn & Co. Analytics GmbH; A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000, kanë shikuar në detaje të gjitha dokumentacionin teknik dhe Ofertën e O.E të shpallur fitues dhe ka konstatuar mospërputhje të mëdha me Specifikacionin Teknikë të Detyrueshëm të Dosjes së Tenderit dhe si rrjedhoje potencojmë që Oferta e Konsorciumit të shpallur fitues duhet të konsiderohet e paligjshme dhe plotësisht e papërgjegjshme dhe si e tillë duhet të refuzohet në tërësi gjatë procesit të ri-vlerësimit të ofertave;

Në këtë drejtim, Oferta e Konsorciumit e shpallur fitues është në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit të Prokurimit Publik sepse Oferta e tillë e dorëzuar nuk është në pajtim me specifikacionet teknike të detyrueshme dhe me nenet 65 – 68 të Ligjit të Prokurimit Publik si dhe me nenin 59 të Ligjit të Prokurimit Publik ngase dokumentet e dorëzuara nuk janë ne pajtim me kushtet dhe kërkesat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe procesi i vlerësimit te ofertave nuk është bëre ne pajtim me kriteret e vlerësimit te ofertave te potencuara ne Dosje te Tenderit..

Me anë të këtij dokumenti, ju ofrojmë, edhe fakte konkrete qe O.E i shpallur fitues për Lot 1 ka ofruar Certifikatën e Akreditimit me afat te skaduar te datës 22.09.2023 (Anëtari Korporata Sara&Meti sh.p.k) dhe skadimi i afatit te kësaj Certifikate te kerkuar specifikisht ne Dosje te Tenderit konsiderohet baze e mjaftueshme ligjore për refuzim te tenderit te këtij O.E.

Per kete ceshtje te skadimit te Certifikates se skaduar te Akredimit te anetarit te konsorciumit Sara & Meti, Autoriteti Kontraktues – KEK sh.a, **ne aprovimin e pjeserishem te Kerkeses per Rishqyrtim, nuk ka ofruar asnje pergjigje ne argumentet ligjore te Konsorciumit tone per ceshtjen e ngritur te skadimit te Certifikates se Akreditimit**.

Siç parashihet edhe me dispozitat ligjore me Ligj te Prokurimit Publik çdo dokument i dorëzuar me Oferte duhet me pas afat te vlefshëm ligjor dhe çdo skadim i këtij afati gjate procesit te vlerësimit te ofertave duhet

te konsiderohet plotësisht dokument i skaduar dhe i njëjti duhet te refuzohet.

Një veprim te tille refuzues Autoriteti Kontraktues nuk e ka bere edhe gjate procesit te Ri-Vlerësimit te Ofertave kur eshte themeluar ky Komision me daten 01 shkurt 2024, kur ka hasur ne Certifikatën e Skaduar te Akreditimit te O.E te shpallur fitues dhe te njëjtit kane bere shkelje ligjore te nenit 59 te Ligjit te Prokurimit Publik gjate procesit te vlerësimit te ofertave dhe nenit 9.1 dhe 9.2 te Dosjes se Tenderit kur janë te specifikuar ne mënyrë te qarte dokumentet dhe certifikatat valide që çdo O.E duhet te i dorëzojë me afat valid para mbylljes se aktivitetit te prokurimit, ashtu siç parashihet me dosje te tenderit.

Prandaj, si rrjedhoje, te argumenteve te potencuara, duhet te ri-konstatojme se edhe anetaret e rinj te Komisionit per Ri-vleresimit te Ofertave, i themeluar me daten 01 shkurt 2024, ka bere shkelje ligjore te nenit 59 te LPP-se duke bere vleresim subjektiv, jo ligjor, jo profesionale dhe favorizues ndaj O.E te shpallur fitues.

Gjithashtu, shihni te bashkëngjitur edhe Shkresën me ane te se cilës stafi ynë ka argumentuar mungesën e akreditimeve për mostrimin e qymyrit, hirit dhe zgurres si dhe mungesës së fotove dhe dokumentacioneve poseduese te pajisjeve te ndryshme teknike sipas kërkesave te Dosjes se Tenderit.

Te gjitha këto fakte dëshmojnë që oferta e Grupit te Operatoreve Ekonomik te shpallur fitues nuk është vlerësuar drejtë dhe ligjshëm nga Autoriteti Kontraktues gjate procesit serishem te Ri-Vlerësimit te ofertave dhe konstatojmë se shkelur rende neni 59 i Ligjit te Prokurimit Publik ku kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues gjate procesit te ri-vlerësimit te ofertave te i marre për baze te gjeturat tona qe Oferta e O.E te shpallur fitues ka mungesa te konsiderueshme qe nuk plotësojnë kërkesat dhe kushtet e Autoritetit Kontraktues dhe te njëjtën O.E te shpallin të papërgjegjshëm gjate procesit te vlerësimit te ofertave (**shih faktet e bashkëngjitur edhe njehere ne Ankese që dëshmojnë se O.E fitues nuk i përmbush kushtet dhe kriteret teknike**).

Po ashtu, gjate shikimit të tërësishëm të Ofertës se O.E te shpallur fitues për Lot 1 nuk kemi vërejtur qe ky O.E ka ofruar Software-in për Llogaritjen e Qëndrueshmërisë se shpateve për Llogaritjen ne forme rrethore dhe poligonale te rrafshit rrëshqitës.

Gjithashtu, te dy Laboratorët e këtij O.E te shpallur fitues për Lot 1: Inkos dhe IMK Ballkan Projekt nuk munden me realizua Testin për provat Triaksale për përcaktimin e ‘j’ dhe ‘c’ ne Q 1.2.9 sepse Laboratori INKOS nuk është i akredituar për Testim Triaksale por është i akredituar vetëm për 4 testime te dherave, Triaksali nuk është nder këto Teste por ky O.E i ka paraqitur ne Foto vetëm si Pajisje.

Ne nderlidhshmeri, me piken 9 te argumenteve ligjore, verehet se KEK me daten 21 prill 2024, themelon komision te ri te vleresimit te ofertave.

Megjithate, edhe komisioni i ri me anetaret e rinj te vleresimit te ofertave japin konkluzion te njejte te refuzimit te argumenteve ligjore te Kerkeses per Rishqyrtim te Konsorciumit tone dhe kerkon sqarime per zevendesim te nje CV-je te ekipi te propozuar te O.E te shpallur fitues.

Asnje argument i yni ligjor nga komisioni i ri i themeluar me daten 21 prill 2024 ne menyre ligjore, thelbesore dhe profesionale nuk eshte shqyrtuar drejte dhe ligjerisht nga KEK per te ofruar kunder argumente ligjore dhe **te njejtin e konsiderojme raport subjektiv dhe jo ligjor ne kundershtim te plote me nenin 59 te LPP-se**, ashtu sic parashihet te behen vleresime te drejta dhe ligjore me proces te verifikimit te tere ofertes si ne aspektin teknik, financiar dhe ligjor.

Ne kete drejtim, KEK, me daten 30 prill 2024, i drejtohet O.E Inkos ne zevendesimin e Znj. Mekaj si pjese e ekipit te propozuar pasi qe e njejta eshte e punesuar ne KEK. Brenda afatit 2 ditor, O.E Inkos propozon dy Inxhinier te Kimise.

Duke u nisur nga kjo, e tere kjo procedure verteton sakte argumentet tona ligjore qe KEK ne fillim te procesit te pare te vleresimit te ofertave por edhe gjate procesit te trete te vleresimit te ofertave eshte dashur te eliminoje nga konkurrenca O.E Inkos ngase i njejti ofron personal te punesuar ne KEK qe ne te njejten kohe sherben edhe si pjesetar i ekipit implementues te O.E te shpallur fitues.

E tere ky **veprim eshte ne kundershtim me Fleten e te Dhenave te Tenderit (9.1 dhe 9.2) te Kerkesave per staf te kualifikuar dhe ne kundershtim me nenin 65 te LPP-se sepse deshmon se O.E i shpallur fitues i mungojne staf i kualifikuar permanent** dhe qe ne menyre te *padrejte dhe jo ligjore favorizohet nga KEK* qe nga muaji Janar 2024 kur jane shpallur fitues per kete aktivitet te prokurimit per Lot 1;

Anetaret e Komisionit per Ri-vleresimin e Ofertave, gjate procesit te serishem te ri-vleresimit, nuk kane ofruar ne Raportin e vleresimit te ofertave, te dates 04 mars 2024, kane heshtur ne teresi ne pretendimet dhe argumentet tona ligjore qe O.E 'INKOS' shpk nuk eshte i akredituar per Testim Triaksale dhe nuk munden me realizu Testin per provat Triaksale.

Ky argument ligjor i Konsorciumit per ceshtjen kontestuese per testime te provave Triaksale qe i mungojne O.E te shpallur fitues qe nuk jane vertetuar nga anetaret e Komisionit per Ri-vleresimit te Ofertave, i themeluar me daten 01 shkurt 2024, jane argumente te mjaftueshme ligjore dhe teknike qe Oferta e O.E 'Instituti INKOS sh.a.; IMK Ballkan Projekt sh.p.k.; Korporata Sara&Meti sh.p.k.; N.SH. Agrovet; Qendra e Monitorimit te Mjedisit RZ Tehnicka Kontrola AD' te shpallet ne teresi oferte e Pa-pergjegjshme dhe e njeta te refuzohet ne teresi.

Në ndërkohë, Laboratori Ballkan Projekt, është i akredituar për Triaksal por nuk e ka paraqitur listën e

pajisjeve.

Në bazë të këtyre dëshmive tona mund te konstatojmë **se mungesa e akreditimit dhe pajisjeve për realizim te testimit Triaksal për 'j' dhe 'c; ne Q.1.2.9, i kerkuar sipas specifikacioneve teknike te detyrueshme, dëshmojnë qartë dhe ligjërisht qe O.E i shpallur fitues për Lot 1 duhet te i refuzohet ne tërësi Oferta dhe te shpallet i papërgjegjshëm** gjate *procesit te Ri-vlerësimit te Ofertave ngase nuk plotëson në tërësi kushtet, kërkesat dhe specifikacionet teknike te detyrueshme*, ashtu siç kërkohet me nenet 9.1 dhe 9.2 te Fletës se te Dhënave te Tenderit, Dosja e Tenderit;

Autoriteti Kontraktues, me daten 25 mars 2024, pjeserisht, ka aprovuar Kerkesen per Rishqyrtim dhe ka derguar perseri lenden ne Ri-vleresim te ofertave me anetar te rinj te komisionit per ri-vleresimin e ofertave pa ofruar asnje argument ligjor se pse lenda kthehet ne Ri-vleresim te ofertave kunderjt argumenteve tona ligjore te prezentuara ne Kerkesen per Rishqyrtim.

Mepastaj, pas disa muajeve, me daten 05 qershor 2024, Autoriteti Kontraktues, leshon Njoftimin per Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me te njejtat arsyetime per refuzim te ofertes se Konsorciumit tone te dhena si ne arsyetimin e pare te refuzimit te dates 04 janar 2024, per kete aktivitet te prokurimit dhe Letren per Tenderuesin e Eliminuar.

Autoriteti Kontraktues KEK, eshte duke refuzuar aplikimin e nenit 59.4 t LPP-se qe oferten tone me gabime te voga teknike te aprovoje si oferte te sukseshme ngase permban te gjitha elementet ligjore te konsiderohet e ligjshme dhe me oferte permbajtesore me cmim me te ulte por per shkak te favorizimit te O.E te shpallur fitues 'INKOS' refuzon te pranoje argumentet tona ligjore.

Edhe pse dy procese te Ri-vleresimit jane bere perseri nuk ka arsyetime konkrete ligjore ne argumentet tona te prezentuara ne Kerkesen per Rishqyrtim. **Ky refuzim i njejte i arsyetimeve te Autoritetit Kontraktues spjegon qarte favorizimin e madh** te Autoriteti Kontraktues ndaj O.E te shpallur fitues INKOS.

Konsorciumit me daten 06 qershor 2024, i drejtohet Autoritetit Kontraktues, per te marre kopjen e raportit te ri-vleresimit te ofertave dhe me daten 07 qershor 2023 ofron qasje ne dokumentacionin publik te O.E Inkos dhe ne raportin e ri-vleresimit te ofertave;

Oferta e Grup i Operatorëve Ekonomik 'Horn and Co. Analytics SH.P.K.; GEOKOS A & A O.P.; Horn & Co. Analytics GmbH; A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000' është oferte me e lire qe ka plotësuar te gjitha kushtet dhe kërkesat teknike te Autoritetit Kontraktues.

Prandaj, Autoriteti Kontraktues, nuk duhet te penalizoje Ofertën e Grup i Operatorëve Ekonomik për një gabim te vogël teknik qe ka ardhur si pasoje e ç`orientimit te stafit tone për shkak se Autoriteti Kontraktues ne nenin 12.1 te Dosje se Tenderit nuk ka cekur qe O.E duhet te specifikojnë 'përqindjen %' e nen-kontraktimit përveç ofrimit te deklaratës për Nen-kontraktuesit dhe qe për këtë gabim teknik te vogël te aplikoje nenin 59.4 te Ligjit te Prokurimit Publik ngase Oferta financiare e Konsorciumit tone është përmbajtjesore dhe nuk përmban ndryshim të konsiderueshëm material ne Oferte dhe është ne vlere totale prej **289,858.98 Euro (me tvsh)** ne krahasim prej ofertës financiare te ofertës se O.E te shpallur fitues ne vlere prej **344,005.40 Euro (me tvsh)** për Lot 1.

Autoriteti Kontraktues, ka obligim ligjore qe te kursej buxhetin e KEK-ut ne këtë rast ne vlere prej **54,146.42 € Euro (me tvsh)** dallim sepse edhe Ligji i Prokurimit Publik kërkon nga Autoriteti Kontraktues qe te realizoje projekte ne mënyrë racionale dhe te kursej fonde kur një O.E ofron çmim te lire qe ka plotësuar te gjitha kushtet dhe kërkesat teknike.

Përndryshe, Konsorciumi, mënyra se si është vlerësuar Oferta e O.E te shpallur fitues pa plotësuar te gjitha kushtet teknike dhe kërkesat e Autoriteti Kontraktues konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka bere diskriminim dhe pabarazi ndaj ofertës se Konsorciumit tone; dhe

Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës, ka bere shkelje ligjore te nenit 59 te Ligjit te Prokurimit por edhe te Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik qe gjate procesit serishem te Ri-Vlerësimit, krahasimit dhe verifikimit te Ofertave te O.E pjesëmarrës ku perseri nuk ka angazhuar ekspert te profileve relevante por vetëm zyrtare te Korporatës qe nuk kane njohuri teknike, financiare, ligjore por edhe ekonomike te bëjnë një vlerësim te drejte, ligjor dhe profesional.

Duke u nisur nga kjo, Konsorciumi, kërkon qe me rastin e kthimit te lendes perseri ne Ri-vlerësim te ofertave dhe te beje emërimin e anëtarëve te rinj te komisionit për vlerësimin e ofertave qe kane përvojë ne industrinë e analizave laboratorike.

Shenim per argumentet ligjore te potencuara ne Ankese dhe faktet e bashkengjitura:

Ne pajtim me Rregulloren per Trajtimin e Ankesave dhe sic parashihet edhe me nenin 108 / A te Ligjit te Prokurimit Publik pretendimet ankimore jane te njejta ku si parashtrues i Ankeses kemi ofruar arsyetimet tona ligjore dhe mos pajtimet ne arsyetimet e ofruara ne Vendimin per Refuzim te Kerkeses per Risqyrtim kundrejt argumenteve ligjore te potencuara ne Kerkesen per Rishqyrtim.

Ne parashtrim te Ankeses ne OSHP bejme edhe deponimin e provave relevante materiale me numer rendor per te i ofruar argumente te mjaftueshme ligjore si Ekspertit teknik shqyrtues por edhe anetareve te Panelit Shqyrtues te OSHP-se per te konstatuar drejte dhe ligjshem gjendjen faktike per lenden e kontestuar.

Perfaqesuesit ligjor ose Perfaqesuesi Teknik (inxhinier te Kompanise), si parashtrues te Ankeses ne OSHP jane ne dispozicion qe sipas Rregullores se Punes se OSHP-se por edhe ne baze te nenit 108 / A te Ligjit te Prokurimit Publik, te ofroje sqarime ligjore lidhur me permbajten e argumenteve tona ligjore dhe teknike (provat) potencuara ne Ankese para Ekspertit dhe Panelit Shqyrtues poqese kerkohen sqarime lidhur me permbatjen e Ankeses.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Grupi i Operatoreve Ekonomik 'Horn and Co. Analytics SH.P.K.; GEOKOS A & A O.P.; Horn & Co. Analytics GmbH; A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000', me plotesimin e te gjitha kerkesave/kushteve te tenderit ka interes te caktuar materialo-juridik ne parashtrimin e Ankeses dhe ka qene nje nga Ofertuesit potencial per fitimin e kontrates publike ngase ka plotesuar te gjitha kerkesat teknike dhe kriteret e Autoritetit Kontraktues dhe ka pasur oferte te pergjegjeshme me cmim me te lire kundrejt te gjithe Ofertueseve tjere.

Prandaj, mos vleresimi i drejte dhe ligjor, ashtu sic kerkohet sipas nenit 59 te Ligjit te Prokurimit Publik dhe mos fitimi potencial i nje kontrate publike ne menyre te rregullte ndikon ne shpenzime ligjore, humbje te fitimit real nga mos realizimi i projektit, si dhe reputacioni i Kompanise sone ne tregun konkurrues te Kosoves.

PROPOZIM

Duke u nisur nga prezentimi i argumenteve ligjore me arsyetim ligjor ne Ankese, Grupi i Operatoreve Ekonomik 'Horn and Co. Analytics SH.P.K.; GEOKOS A & A O.P.; Horn & Co. Analytics GmbH; A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000', kerkon si nga Eksperti Teknik Shqyrtues por edhe anetaret e Panelit Shqyrtues te Organit Shqyrtues te Prokurimit te beje shoshitjen e fakteve ne menyre ligjore, objektive, profesionale dhe te drejte duke marre Vendim per te kthyer lenden e kontestuar ne RI-VLERESIM te OFERTAVE, ne menyre qe Autoriteti Kontraktues – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES, te beje vleresim te serishem te Ofertave me anetar te rinj te komisionit vleresues dhe te shpall fitues Grupin e Operatoreve Ekonomik 'Horn and Co. Analytics SH.P.K.; GEOKOS A & A O.P.; Horn & Co. Analytics GmbH; A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000', qe ka plotesuar te gjitha kushtet, kerkesat dhe kriteret e Autoritetit Kontraktues te potencuara ne Dosje te Tenderit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*